

URDHËR
Nr. 311, datë 3.5.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR TRAJTIMIN E ÇËSHTJEVE
KONSULLORE

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, nenet 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8372, datë 9.7.1998, “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore”, ligjin nr. 90/2012, “Për administratën publike”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për trajtimin e çështjeve konsullore te Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

2. Sekretari i Përgjithshëm ngarkohet për nënshkrimin e akteve me karakter konsullor që nuk përfshihen në paragrafin 4 (katër) të këtij urdhri.

3. Sekretaria Qendrore qarkullon kundrejt nënshkrimit të drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore dokumentet hyrëse në institucion me karakter të qartë konsullor. Rastet e tjera qarkullohen sipas rregullit të përgjithshëm të dokumenteve hyrëse.

4. Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore është personi përgjegjës për nënshkrimin e akteve vijuese:

a) përcjellje e akteve të gjendjes civile, lejeve të drejtimit, pasaportave, sendeve të humbura, specimene të dokumenteve shqiptarë apo të huaj;

b) verifikim dokumentacioni (të lëshuara nga institucionet shqiptare), identiteti për shtetasit shqiptarë, figurë për kandidatët për konsuj nderi të RSH-së dhe të huaj;

c) nota verbale mbështetëse për vizë për institucionet, si edhe diplomatet e emëruar, përgjigje me karakter konsullor letrat hyrëse për shtetasit afganë;

ç) kërkesat për çelje-mbyllje aksesesh për diplomatë, operatore tek Identitek, MB-ja, MD-ja;

d) shkresa shoqëruese për postën diplomatike që përmban pasaporta materiale të identitek;

dh) përcjellje praktikash për heqjen dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare;

e) përcjellje praktikash për heqjen dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare;

ë) përcjellje kërkesash për ekstradim, ndihmë juridike, ndalim, arrestim për shtetas shqiptarë e huaj.

5. Sekretari i Përgjithshëm ngarkohet për nënshkrimin e akteve me karakter konsullor që nuk përfshihen në paragrafin 3 të këtij urdhri.

6. Njoftimet dhe komunikimet elektronike, për çështjet konsullore, i drejtohen drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore. Për çdo çështje vihet në dijeni Sekretari i Përgjithshëm.

7. Të gjitha njoftimet për çështjet konsullore, publikimi i aktiviteteve konsullore në faqet zyrtare dhe llogaritë zyrtare të rrjeteve sociale të MEPJ-së dhe të misionëve diplomatike/posteve konsullore të RSH-së bëhen me miratim të Sekretarit të Përgjithshëm, sipas propozimeve të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, në bashkëpunim me kabinetin e ministrit.

8. Titullarët e misionëve diplomatike dhe posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë i raportojnë për veprimtarinë konsullore, në bazë ditore, drejtorit të drejtorisë që mbulon çështjet konsullore.

9. Drejtori i drejtorisë që mbulon çështjet konsullore i raporton në bazë ditore veprimtarinë konsullore të ushtruar nga përfaqësitë/postet konsullore Sekretarit të Përgjithshëm.

10. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror, Drejtorja e Çështjeve Konsullore, kabineti i ministrit, titullarët dhe punonjësit konsullorë në misionet diplomatike dhe postet konsullore të RSH-së.

11. Ngarkohen me njoftimin e këtij urdhri strukturat e institucionit dhe misionet diplomatike e konsullore, Sektori i Menaxhimit të Dokumentacionit në Drejtorinë e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

12. Urdhri i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 454, datë 31.8.2022, “Për çështjet konsullore”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani